



Një ditë në jetën e ...

Çfarë personi do t'i pëlqente kjo punë?

-
-
-
-
-

Cilat janë aftësitë e kërkuara për këtë punë?

-
-
-
-
-

Çfarë është avancimi në karrierë për dikë që bën këtë punë?

-
-
-
-
-

Një ditë në jetë – Valbona Fetiu Mësuese



Orët	22 orë në javë - punoj rregullisht paradite
Paga	E pamjaftueshme
Shkollimi	Fakulteti i Mësuesisë
Pse e keni zgjedhur	Më pëlqen puna me fëmijët
Një ditë tipike	<p>Zgjohem në orën 6.30, përgatitem dhe nisem sa më e qetë për në shkollë.</p> <p>Në shkollë takohemi me kolegët dhe kujdesemi që të gjithë nxënësit të jenë gati për mësim. Lexoj edhe një herë planin mësimor për këtë ditë dhe filloj orën e parë të mësimin e cila fillon në orën 8.00. Në varësi të programit mësimor ditor kujdesem gjatë ditës për mbarëvajtjen e mësimin.</p>
Gjëja më e mirë	Mundësia që të mësosh dhe të ndihmosh nxënësit



Orët	Rreth 50 orë në javë - punoj në dy turne, ndonjëherë edhe natën dhe fundjavave
Paga	E pamjaftueshme
Shkollimi	Fakulteti i Infermierisë
Pse e keni zgjedhur	Më pëlqen të punoj me njerëz të sëmurë, t'i ndihmoj ato dhe t'i lehtësoj dhimbjet.
Një ditë tipike	<p>Zgjohem rreth orës 6.00 të mëngjesit nëse filloj punën në orën 7.00. Pi një kafe dhe nisem për në punë. Kur arrij në punë, së pari konsultohem me mjekun, shikoj detyrat që më presin për ditën dhe listën e pacientëve që kanë nevojë për ndihmën time. Rreth orës 8.00 fillon kontrolli i pacientëve, shpërndarja e ilaçeve dhe bërja e injeksioneve dhe shërbimeve të tjera gjatë ditës.</p> <p>Ne duhet të kemi kujdes të sillemi mirë me pacientët edhe kur ata nuk sillen mirë me ne, dhe të jemi të buzëqeshur tërë kohën.</p> <p>Në fund të orarit të punës duhet të jemi të sigurt që të gjitha shërbimet që janë caktuar për atë ditë janë përmbushur dhe pastaj shkojmë në shtëpi.</p> <p>Gjithashtu duhet të jemi fleksibël në orarin e punës, nëse është e nevojshme për ndonjë rast urgjent duhet të qëndrojmë më gjatë në punë.</p>
Gjëja më e mirë	Ndihmoj të tjerët
Gjëja më e keqe	Rastet kur nuk mund të shpëtohet jeta e pacientit

Një ditë në jetë – Chris Evans

Kamerier



Orët	Rreth 55 orë në javë - punoj deri natën vonë dhe shpesh edhe fundjavave
Paga	E pamjaftueshme
Shkollimi	Kurs 6-mujor
Pse e keni zgjedhur	Më pëlqen të punoj me njerëz
Një ditë tipike	<p>Nëse kam punuar deri vonë natën e kaluar, zgjohem rreth orës 8.00 të mëngjesit. Pi kafën. Shkoj në restorant në orën 10.30. Nëse jam në shërbim gjatë drekës tavolinat duhet të jenë të rregulluara kështu që përgatis menytë dhe shkëmbej ndonjë fjalë me kolegët. Klienti i parë arrin rreth orës 11.45 dhe që nga ky moment ka rrëmujë dhe shumë njerëz në restorant për disa orë. Ne duhet të jemi të buzëqeshur bile edhe kur gjërat nuk shkojnë aq mirë.</p> <p>Kur përfundon dreka ne pastrojmë dhe diskutojmë për turnin e mbrëmjes. Turni i mbrëmjes është me më pak njerëz të cilët fillojnë të shfaqen rreth orës 6.00. Ne vrapojmë nëpër tavolina klientësh disa orë duke përfunduar në mesnatë. Pas punës, ne pimë nga një pije të shpejtë dhe kthehemi në shtëpi.</p>
Gjëja më e mirë	Shumëllojshmëria
Gjëja më e keqe	Orari i gjatë